



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**NR. AKTI 13**  
**04.05.2020**

**NR. VENDIMI 20**  
**03.06.2020**

**V E N D I M**  
**“P E R S E K U E S T R I M I N E P A S U R I S E”**

Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e përbërë nga :

**Gjyqtar : Klodian KURUSHI**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Nesila Xhemali**, sot më datë 03. 06. 2020, ora 11. 00, zhvilloi gjykimin në seancë gjyqësore të kërkesës për masën parandaluese të revokimit të sekuestrimit që i përket;

**K E R K U E S :**

**1. E.S**, e bija e XXXXXX dhe e XXXXXXXXXXe datëlindjes xx. xx. Xxxx lindur dhe banues në Durrës, bashkëshortja e shtetasit B.S , e gjykuar nga mungesë, me prokurën e posaçme lëshuar prej saj në 10. 02. 2020 në Belgjikë e shoqëruar me “Vulë Apostile” ajo ka autorizuar përfaqësuesit e saj ligjorë, avokatët Alban Bengasi dhe Elton Hyseni të përfaqësojnë interesat e kërkueses në mungesë të saj në këtë proces gjyqësor. Në seancat gjyqësore të zhvilluara është paraqitur mbrojtësi Elton Hyseni me nr. 2719 Licence dhe NIPT (NUIS) K01404048A, anëtar i Dhomës së Avokatisë, Tiranë.

**2. Shoqëria “XXX Xxxxxxxx”** regjistruar në QKB me (NUIS) LXXXXXXXQ me administrator shtetasin S.O, i cili me prokurën e posaçme me nr. 4181 rep/1697 kol datë 13. 05. 2020 ka autorizuar përfaqësuesit e saj ligjorë, avokatët Alban Bengasi dhe Elton Hyseni të përfaqësojnë interesat e shoqërisë në mungesë të saj në këtë proces gjyqësor. Në seancat gjyqësore të zhvilluara është paraqitur mbrojtësi Elton Hyseni me nr. 2719 Licence dhe NIPT (NUIS) K01404048A, anëtar i Dhomës së Avokatisë, Tiranë.

**P A L Ë N Ë P R O C Ë S :**

Prokuroria pranë Gjykatës se Shkallës së Parë “Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” Tiranë, përfaqësuar nga nga Prokurori **Vladimir Mara**.

**O B J E K T I :**

Revokimin e Sekuestrimit të pasurive si më poshtme:

Pasuria nr.154/XXXvol.11 fq.230, Z.K.2574, e llojit Arë+Truall me sipërfaqe 5954m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe ndërtesë 3070m<sup>2</sup>, e cila figuron në

pronësi të shtetases E.S.

Pasuria nr. 381/XXvol.1 fq.116, zk,2704, e llojit ullishtë me sipërfaqe 6550m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me shtetasit A.H, D.O dhe M.LL.

Aseteve, aksioneve/kuotave, dhe pasurive të subjektit “XXX XXXXXXXXX” sh.p.k. me NIPT LXXXXXXXXXQ, me status aktiv. Me administrator z. S.O dhe aksionere me 100% të aksioneve shtetasen E.S, si dhe të subjektit “B.S” me Nipt LXXXXXXXXXH, me aktivitet fast food me status aktiv.

**BAZA LIGJORE:** Neni 12/b, i Ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nenet 207 të K. Pr. Civile.

Në përfundim të gjykimit palët në proces kërkuan:

**Pala kërkuese:** Revokimin e masës së sekuestros vendosur nga gjykata me vendimin e saj me vendimin nr. 3 datë 07. 02. 2020.

**Prokuroria:** Rrëzimin e kërkesës.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, adminstroi provat, që lidhen me kërkesën e paraqitur

**V Ë R E N:**

***Rrethanat e faktit***

Prokuroria “Kundër Korrupsioni dhe Krimin të Organizuar” me datë 04. 02. 2020 ka regjistruar procedimin pasuror nr. 01 te vitit 2020 ne ngarkim te subjekteve të të përmendur më lart dhe personave të tjerë lidhur me ta.

Në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. 94 i vitit 2019 për veprat penale të “Trafikimit të narkotikëve”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarise kriminale” dhe “Grupi i strukturuar kriminal” të parashikuara nga nenet 283/a, 287 dhe 333/a të K.Penal, lidhur me procedimin penal nr. 139 të vitit 2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Ky procedim është regjistruar pasi, me shkresën Nr.297/1 Prot, datë 17.07.2018, të Ministrisë së Drejtësisë në Tiranë, i është dhënë rrugë kërkesës për marrëveshje, për krijimin e një skuadre të përbashkët hetimore, midis Prokurorisë së Barit të Republikës së Italisë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kërkesë e cila ka ardhur në trajtën e ndihmës juridike të autoriteteve Italiane të Drejtësisë, përkatësisht të Zyrës së Prokurorit pranë Gjykatës së Barit në Itali, Seksioni DDA, në lidhje me procedimin penal Nr.5656/17R.G mod.21, për veprën penale të “Organizatës kriminale me qëllim trafikimin e narkotikëve”.

Në këto rrethana, referuar akteve të dërguara me kërkesë për ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore nga autoritetet italiane të drejtësisë, ka të dhëna të mjaftueshme se faktet e ndodhura më parë dhe që vijnë të kryhen se përbëjnë elemente e figurave të veprave penale të “Trafikimit të narkotikeve”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarise kriminale” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 283/a, 287 dhe 333/a i K.Penal, dhe me qëllim dokumentimin e faktit dhe të personave të përfshirë në këtë aktivitet kriminal lindi e nevojshme regjistrimi i procedimit penal dhe fillimi i ushtrimit të ndjekjes penale për veprën penale të mësipërme. Për këtë më datë 20.07.2018 u regjistrua procedimi penal Nr.139. Me datë 26.07.2018 u ngrit skuadra e përbashkëta hetimore me autoritetet italiane të drejtësisë dhe u nënshkrua marrëveshja.

Gjatë hetimeve është bërë e mundur të identifikohet shtetasi i shumë kërkuar nga autoritetet italiane të drejtësisë G Di C, i shpallur në kërkim ndërkombëtar. Më datë 05.12.2018 në koordinim me autoritetet italiane në kuadër të një operacioni të përbashkët në orët e para të mëngjesit Forcat Operacionale të Policisë së Shtetit kanë ekzekutuar urdhërin e kërkimit ndërkombëtar për arrestimin e shtetasit italian G Di C. Për shtetasin G Di C në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës është zhvilluar seanca gjyqësore lidhur me ekstradimin e tij në Itali dhe me vendimin Nr. (11-2019-2823) 491/1 datë 18.03.2019 është vendosur ekstradimi me kusht për shkak të hetimit lidhur me procedimin penal nr. 139 të vitit 2018.

Gjatë hetimeve të këtij grupi të strukturuar kriminal të dyshuar, ka rezultuar se shtetasi B.S alias H, i biri i B dhe i F, i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Brezhdan Dibër dyshohet se ka pasur lidhje me shtetasin G Di C. Në kuadër të këtij procedimi penal, bazuar në shkresën e autoriteteve të Drejtësisë Italiane, përkatësisht nga Karabinieria Puglia, Komanda Provinciale e Barit dhe konkretisht në shkresë nr. 86/57-109 prot. Bari, 26 korrik 2018, ka rezultuar se në muajin maj 2017 G dhe C Di C (përkatësisht babai dhe vëllai I G di C) janë arrestuar në bazë të urdhërit të masës së sigurisë arrest me burg pasi janë të dyshuar për trafikim të lëndëve narkotike. Nëpërmjet personave ndaj të cilëve është dhënë masa shtrënguese rezultoi edhe shtetasi B H, lindur në Shqipëri x korrik xxxx banues në Shqipëri, Itali dhe

Vëndet e Ulëta. Në kuadër të një operacioni tjetër të policisë, subjekti në fjalë është arrestuar në Belgjikë pasi posedonte 330 kg kokainë. Në kuadër të këtij procedimi penal janë bërë verifikimeve pasurore, për shtetasin B.S alias H, i biri i B dhe i F, i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në Brezhdan Dibër si dhe për familjarët dhe persona të dyshuar të lidhur me të, bazuar në ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”( i ndryshuar).

Në vazhdim të këtij hetimi pasuror dhe në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i është kërkuar informacion të gjitha bankave, Interpolit, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe nga institucionet e mësipërme kemi administruar dokumentacionin si më poshtë:

– Në vijim të hetimeve sipas shkresës nr.9853kl. prot. SA567/17 datë 21.08.2019, të Zyrës Qëndrore të Interpolit, nga verifikimet e bëra në arkivën e Interpolit ka rezultuar se nga Interpol Bruksel, në databazat policore belge, shtetasi *B.S alias H*, i biri i B dhe i F, i datëlindjes xx.xx.xxxx, figuron me rekorde kriminale në veprat penale “Shkelje e ligjit për narkotikët dhe falsifikim dokumentash”. Ky shtetas është ndaluar që më datë 12.05.2018 për veprën penale “Shkelje e ligjit për narkotikët ”.

– Me shkresën nr.1843/1 prot. datë 06.11.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave jemi informua në lidhje me aktivitetin financiar për shtetasin B.S alias H apo familjarët e tij. Gjithashtu informohemi se nga një hetim i gjatë në shkurt të vitit 2009 Carabinieri i Caprios, në koordinim me kapiten D’Amato arrestuan gjatë një kontrolli rutinë dy shtetas rreth të 20-ve, me origjinë shqiptare H B dhe A.G të dy banorë midis Firences, Peruxhias dhe Romës, të cilët u kapën me një sasi prej 10 kg kokainë.

– Përsa i përket informacionit të administruar nga bankat ka rezultuar se:

- Në Bankën Raiffeisen shtetasja E.S ka llogari me gjendje 1,981,946 lekë.
- Shtetasi R.Ska llogari me gjendje 1,121,298 lekë.
- Në Credins Bank shtetasja L.S ka llogari me gjendje 19.000 euro
- Në Tirana Bank shtetasi B.S me balancë 2.022 euro.

Gjithashtu shtetasi B.S alias H apo familjarët e tij figurojnë që të kenë hapur dhe mbyllur llogari në banka të ndryshme.

– Pas verifikime të bëra në sistemin tatimor C@TS nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, sipas shkresës Nr.prot. 18322/1 datë 11.10.2019, ka rezultuar se: shtetasi B.S alias H i biri i B dhe i F, i datëlindjes xx.xx.xxxx, është pronar i subjektit “B.S” me Nipt LXXXXXXXXXD, i cili është me status pasiv që në datë 08.06.2016.

Gjithashtu subjektit “B.S” me Nipt LXXXXXXXXXH, me aktivitet fast food rezulton me status Aktiv. Për shtetasen E.S, e bija e E dhe e L, e datëlindjes xx.xx.xxxx, rezulton aksionere me 100% të aksioneve për subjektin “XXX XXXXXXXXX” sh.p.k. me NIPT LXXXXXXXXXQ, me status aktiv.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.4401/1 prot. datë 04.04.2019, jemi informuar se tatimpaguesi "XXX XXXXXXXXX" sh.p.k. me NIPT LXXXXXXXXXQ, figuron i regjistruar si tatimpagues në DRT Durrës. Administratori S.O dhe aksionere E.S, me 100% të aksioneve. Objekti i aktivitetit prodhime plastike për eksport etj. Bashkalidhur janë dërguar edhe pasqyrat financiare.

Nga kontrolli në Arkivën Kombëtare të Regjistrimit të Mjeteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas shkresës Nr.20828/1 prot. datë 14.10.2019, rezulton se figurojnë në pronësi të famijarëve të shtetasit B.S alias H, mjetet si më poshtë:

Mjetet me targa AA XXX NF, e markës Fiat, modeli 500, e vitit të prodhimit 2008 dhe AA XXX PB, markës Land Rover, modeli RANGE ROVER, e vitit të prodhimit 2014 në pronësi të shtetasës E.E;

Mjetet me targa AA XXX CY, e markës AUDI, modeli A2, e vitit të prodhimit 2001 në pronësi të shtetasës A.M H;

Mjetin me targa AA XXX OB, e markës Fiat, modeli 500L, e vitit të prodhimit 2014 në pronësi të shtetasit E.O.S;

Mjetet me targa AAXXXMJ, e markës Mercedes Benz, modeli B180 CDI, e vitit të prodhimit 2012 në pronësi të shtetasës A.S;

– Përsa i përket pasurive të paluajtshme nga informacioni i administruar nga Zyrat Vendore të Agjensisë së Kadastrës ka rezultuar se:

- 1- Bazuar në shkresën nr.4233/1 prot. datë 22.10.2019 të Zyrës Vendore të Kadastrës Dibër, se shtetasi B.S H ka përfituar si përfaqësues i familjes bujqësore në bazë të ligjit 7501 datë 19.07.1991, me AMTP nr. 1943.
- 2- Bazuar në shkresën nr.6655/1 prot. datë 23.10.2019 të Zyrës Vendore të Kadastrës Tiranë Rurale 1, se shtetasi A.H, figuron një pasuri me këto të dhëna: pasuria nr.381/xx vol.1 fq.116, zk,2704, e llojit ullishtë me sipërfaqe 6550m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me shtetasit D.O dhe M.LL.

Në zbatim të vendim për këqyrjen e marrjen e dokumentave datë 28.01.2020, në Zyrën Vendore të Kadastrës Durrës janë marrë me këqyrje marrje fotokopje të njësuara me origjinalin e kartelës së pasurisë së bashku me praktikat e fitimit të pronësisë si dhe të gjitha referencat për veprimet që janë kryer më Pasurinë nr.154/xxx vol.11 fq.230, Z.K.25xx, e llojit Arë+Truall me sipërfaqe 5954m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasës E.S. Kjo pasuri është blerë nga shtetasja E.S me kontratën e shitjes Nr.1859 Rep Nr.933/1 Kol datë 19.10.2016, në shumën 150.000 euro. Në këtë pasuri me referecën nr.4292 është regjistruar

leje legalizimi për godinë ekonomike me sipërfaqe 3070m<sup>2</sup>.Ndërsa me referencën nr.4457 është bërë rivlerësimi i kësaj pasurie në shumën 205,262,470 lekë dhe nga akti i vlerësimit ka rezultuar se kjo pasuri është vlerësuar në shumën 1,514,070 euro. Nga analiza fakteve dhe e dokumentacionit të administruar përsa i përket pasurive të shtetasit B.S alias H, i biri i B dhe i F, i datëlindjes xx.xx.xxxx dhe familjarëve të tij, rezulton se kanë një nivel të pajustificuar ekonomik dhe dyshohet se këto pasuri të paluajtshme apo të luajtshme, mund ti kenë fituar si rezultat i veprimtarisë së tyre kriminale që ata kanë zhvilluar në Shqipëri, në Itali dhe në Belgjikë.

Pasuritë e shtetasi B.S alias H, familjarëve dhe personave të lidhur të tij, sipas kërkeses për sekuestrim nga prokuroria dyshohet se janë vendosur nga të ardhurat e krijuara nga aktiviteti kriminal dhe bazuar në nenin 11 të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 *“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* prokurori ka kërkuar të vendoset sekuestro mbi këto pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr.154/XXXvol.11 fq.230, Z.K.2574, e llojit Arë+Truall me sipërfaqe 5954m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe ndërtesë 3070m<sup>2</sup>, e cila figuron në pronësi të shtetases E.S.
- Pasuria nr. 381/XXvol.1 fq.116, zk,2704, e llojit ullishtë me sipërfaqe 6550m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me shtetasit A.H, D.O dhe M.LL, ku të sekuestrohet pjesa takuese e shtetasit A.H;

Përsa i përket pasurive të paluajtshme prokuroria ka kërkuar të vendoset sekuestro edhe për pasurinë e luajtshme të shtetases E.E dhe konkretisht:

Mjetet me targa AA XXX NF, e markës Fiat, modeli 500, e vitit të prodhimit 2008 dhe AA XXX PB, markës Land Rover, modeli RANGE ROVER, e vitit të prodhimit 2014 në pronësi të shtetases E.E;

Mjetet me targa AA XXX CY, e markës AUDI, modeli A2, e vitit të prodhimit 2001 në pronësi të shtetases A.M H;

Mjetin me targa AA XXX OB, e markës Fiat, modeli 500L, e vitit të prodhimit 2014 në pronësi të shtetasit E.O.S;

Mjetet me targa AAXXXMJ, e markës Mercedes Benz, modeli B180 CDI, e vitit të prodhimit 2012 në pronësi të shtetases A.S;

Gjithashtu prokuroria ka kërkuar të vendoset sekuestro të asetëve, aksioneve/kuotave, pasurive të subjektit “XXX XXXXXXXXXX” sh.p.k. me NIPT LXXXXXXXXXQ, me status aktiv me administrator z. S.O dhe aksionere me 100% të aksioneve shtetasen E.S,

si dhe të subjektit “B.S” me Nipt LXXXXXXXXXH, me aktivitet fast food me status aktiv.

Përsa i përket shumave të parave të administruar nga bankat e nivelit të dytë prokuroria ka kërkuar të vendoset sekuestro të shumave që ndodhen në llogaritë si më poshtë:

- Llogari dhe shuma në Bankën Raiffeisen të shtetases E.S me gjendje 1,981,946 lekë.
- Llogari dhe shuma në Bankën Raiffeisen të shtetasis R.S me gjendje 1,121,298 lekë.
- Llogari dhe shuma në Credins Bank të shtetases L.S me gjendje 19.000 euro
- Llogari dhe shuma në Tirana Bank të shtetasi B.S me balancë 2.022 euro.

Me vendimin nr. 03 datë 07. 02. 2020 gjykata e shkallës së parë “Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” Tiranë mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria ka vendosur sekuestrimin e pasurive të përshkruara më lart. Sekuestrimi i pasurive është bazuar në Ligjin nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” (Ligji parandalues).

### ***Kërkesa e palës kërkuese***

Pala kërkuese ka kërkuar revokimin e masës së sekuestros të vendosur nga gjykata mbi pasuritë e përmendura më lart me argumentimin se aksioneria e shoqërisë “XXX XXXXXXXX” dhe vetë shoqëria në veprimtarinë e saj ekonomike ka respektuar të gjithë kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë. Të ardhurat e fituara nga kërkuesja Eriola Seferi për krijimin e shoqërisë “XXX XXXXXXXX” si dhe të ardhurat e krjuara nga vetë shoqëria, kanë ardhur nga burime të ligjshme dhe për këtë arsye masa e sekuestrimit të vendosur mbi këto pasuri duhet të revokohet.

Pala kërkuese ka paraqitur si provë:

- Një kontratë shitblerje toke trualli me sipërfaqe 5600 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit prej 18 450 000 Lekë me palë shitësa shtetasis B.H, E.B, L.H, M.H, L.H, L.H, M.SH dhe blerës shoqëria “A.B” shpk me përfaqësues shtetasis A.M dhe A.D.

- Deklaratë noteriale nr. 317 rep dhe nr. 117/2 kol datë 12. 02. 2020 me deklarues shtetaset F.H dhe L.S nga ku rezulton se në vitin 2004 deklaruesja F.H dhe bashkëshorti i saj B.H i kanë dhuruar vajzës së tyre L.H (mamaja e E.H) shumën prej 4 500 000 lekë të cilën e kanë përfituar nga shitja e një trualli në lagjen nr. XX Shkozet – Durrës.

- Deklaratë Noteriale nr. 391 rep dhe nr. 143 kol dt. 19. 02. 2020 me deklarues shtetasis A.H dhe L.S nga ku rezulton se në vitin 2004 babai i deklaruesit i ndjeri M.R.H i ka dhuruar vajzës së vëllait të tij znj. L.S shumën prej 4 500 000 lekë të cilën e kishte përfituar nga shitja e një trualli në lagjen nr. XX Shkozet Durrës.

- Kontratë shitblerje pasurie nr. 3258 rep dhe nr. 839 kol datë 08. 10. 2007 me palë shitësa shtetasit H.H, N.R, B.H, A.H dhe blerës shtetasin A.R, ku rezulton se një pasurie e paluajtshme e llojit apartament ndodhur në Durrës me sipërfaqe 59, 67 m<sup>2</sup> është shitur kundrejt çmimit 9 700 000 lekë.

- Deklaratë noteriale nr. 398 rep/145 kol datë 19. 02. 2020 me deklarues shtetasit A.H dhe L.S nga ku deklarohet se shtetasja L.S ka marrë hua pa akt noterial dhe pa interes në vitin 2010 djalit të xhaxhait të saj z. A.H shumën prej 9 000 000 lekë që i nevojitej për zhvillimin e një aktiviteti privat familjar. Ajo deklaron se do t' ja likuideojë shtetasit shumën deri në afatin limit të rënë dakord midis tyre në datë 30. 12. 2025.

- Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme tokë bujqësore datë 19. 10. 2016 me shitësa shtetasit A.H dhe P.H si dhe blerës shtetasen E.S, çmimi i blerjes së tokës arë në Xhafzotaj Durrës me sipërfaqe 5954 m<sup>2</sup> ishte në vlerën 150 000 euro.

- Tre kontrata shitblerje për pasuri të paluajtshme në datat 26. 04. 2014 për te apartamente që ndodhen në Durrës me sipërfaqe 68 m<sup>2</sup> , 121, 7 m<sup>2</sup>, 121, 7 m<sup>2</sup> të lidhur me palët I.M dhe P.P në vlerat 70 000 euro, 100 000 euro dhe 100 000 euro.

- Deklaratë noteriale nr. 2462 rep dhe 1157 kol datë 14. 10. 2016 midis shtetasve I.M dhe E.S nga ku deklarohet se shtetasi I.M i jep hua znj. E.S një vlerë monetare prej 150 000 euro nëpërmjet transaksionit bankar për arsye se kjo shumë i nevojitet për blerjen e një pasurie të paluajtshme. Shuma do ti kthehet brenda pa interes brenda datës 31. 12. 2021.

- Kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme dt. 3. 11. 2016 për pasurinë e paluajtshme tokë arë në Xhafzotaj, Durrës me sipërfaqe 5954 m<sup>2</sup>.

- Kontratë huadhënie dt. 08. 04. 2017 midis shtetasit S.O dhe shoqërisë “XXX XXXXXXXXX” për shumën e huasë prej 10 000 000 lekë pa interes me afat shlyerje deri në datë 08. 04. 2018.

- Kontratë huadhënie datë 11. 04. 2018 midis shtetasit S.O dhe shoqërisë “XXX XXXXXXXXX” për shumën prej 10 000 000 lekë midis shtetasit S.O dhe shoqërisë “XXX XXXXXXXXX” me afat shlyerje brenda datës 08. 04. 2023.

- Kontratë huadhënie datë 26. 04. 2017 midis shtetasit B.S dhe shoqërisë “XXX XXXXXXXXX” për shumën prej 59 000 euro me afat shlyerje deri në datë 26. 04. 2018.

- Kontratë kredie bankare datë 25. 03. 2019 midis “Union Bank” sh.a. dhe shoqërisë “XXX XXXXXXXXX” për shumën e kredisë prej 400 000 euro afati 72 këste shlyerje në cdo muaj, kredi e marrë për veprimtarinë e shoqërisë.

- Kontratë furnizimi dt. 12. 01. 2010 lidhur midis shtetasës E.S dhe shoqërisë “XXXXXXXXX” shpk ku furnizuesi që në këtë rast është shoqëria ka furnizuar me materiale ndërtimi shtetasen E.S për ndërtimin e objektit magazinë ku ushtron veprimtarinë tregtare shoqëria “XXX XXXXXXXXX” me adresë në Xhafzotaj, Durrës. Shlyerja e pagesave do të



jetë për një afat 10 vjecar.

- Raport vlerësimi për pasurinë e paluajjtshme arë + truall me sipërfaqe 5954 m<sup>2</sup> (truall dhe ndërtesë) ndodhur në fshatin Xhafzotaj, Durrës.

Në vlerësimin e prova të sjella, pala kërkuese argumentoi para gjykatës së masa e sekuestrimit për pasuritë e sekuestruara duhet të revokohet pasi pala kërkuese justifikon me burime të ligjshme të gjitha pasuritë që janë në pronësi të saj dhe shoqërisë "XXX XXXXXXXX". Kërkesa për revokimin e sekuestrimit është mbështetur në nenin 12/b të Ligjit nr. 10192 datë

03. 12. 2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë" (Ligji parandalues).

### ***Ligji i zbatueshëm***

Neni 12/a

#### **Sekuestrimi ose konfiskimi i pasurisë së barasvlershme**

*(shtuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)*

1. Sekuestrimi ose konfiskimi vendoset mbi mjete monetare ose mbi çdo pasuri tjetër në zotërim të personave të përmendur në nenin 3, të këtij ligji, kur, pas marrjes në dijeni për hetimet në ngarkim të tij, personi, kundër të cilit kërkohet të vendoset masa tjetëron, shpërndan, transferon, shpërdoron, fsheh ose zhvlerëson pasurinë, me qëllimin për të shmangur ekzekutimin e masës së sekuestrimit ose konfiskimit të saj.
2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, kur personi i tretë është në keqbesim, pasuria sekuestron ose konfiskohet.
3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen, deri në masën e vlerës së pasurisë, për të cilën është vendosur sekuestrimi ose konfiskimi, edhe kur del që ajo është bashkuar me pasuri të tjera.
4. Rregullat e pikave të mësipërme të këtij neni zbatohen edhe kur pasuria e paligjshme është trupëzuar me pasuri të ligjshme dhe nuk mund të ndahet prej saj pa i shkaktuar një dëm thelbësor.

Neni 12/b

#### **Revokimi i sekuestrimit**

*(shtuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017)*

1. Gjykata, me kërkesë të palëve, vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë edhe përpara afatit të parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 12, të këtij ligji.
2. Gjykata vendos revokimin e sekuestrimit të pasurisë, duke e zëvendësuar atë me pasuri të barasvlershme, kur palët japin pëlqimin dhe gjykata e çmon të përshtatshme.

### ***Vlerësimi i gjykatës***

Referuar nenit 12 të Ligjit Parandalues, vendimi i sekuestrimit është i ekzekutueshëm me shpalljen e tij dhe masa e sekuestrimit është e vlefshme për një periudhë gjashtë mujore duke filluar të llogaritet nga dita e ekzekutimit të saj. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për revokimin e masës së sekuestrimit, pala kërkuese paraqiti prova të cilat lidhen drejtpërdrejt me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të sekuestruara. Në fakt këto prova lidhen themelin e çështjes gjyqësore. Burimi ose jo i ligjshëm i të ardhurave të siguruara nga pala kërkuese për krijimin e sendeve të sekuestruara është një e drejtë që Ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 "Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë" (Ligji parandalues), ja ka njohur palës kundër të cilës është vendosur masa parandaluese gjatë gjykimit të kërkesës së konfiskimit të pasurive.

Në rastin konkret, procedimi pasuror sipas ligjit parandalues, ndodhet në fazën e verifikimit

të pasurisë që po kryehet nga ana e prokurorisë referuar nenit 8 e vijues të “Ligjit Parandalues”. Pas marrjes së vendimit të gjykatës për sekuestrimin e pasurive të kërkuara nga prokuroria, për shkak të rrezikut të humbjes, fshehjes ose tjetërsimit të tyre, prokuroria ka vijuar me verifikimin e burimeve që kanë shërbyer në krijimin e pasurive si dhe personave të përfshirë në këtë veprimtari.

Kërkesa për konfiskimin e pasurive nuk është paraqitur nga prokuroria për tu shqyrtuar në gjykatë. Vetëm në rastin e paraqitjes së kërkesës për konfiskim, pala kundër së cilës është vendosur masa parandaluese ka të drejtën ligjore në përputhje me nenin 21 pika 3; 4; 5 e vijues të Ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” (Ligji parandalues) të paraqes prova e nevojshme për të përligjur burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive për të cilat kërkohet konfiskimi.

Pra kërkimet dhe provat e paraqitura nga pala kërkuese në këtë proces gjyqësor në thelb i referohen një faze tjetër gjykimi që është shqyrtimi i kërkesës për konfiskim, e cila deri në këtë moment nuk ka filluar të zhvillohet. Shqyrtimi i kërkesës për konfiskim realizohet me paraqitjen e kërkesës së prokurorit për konfiskimin e pasurive që në vlerësimin e tij dyshohen se kanë lidhje me vepra penale.

Provat e paraqitura nga pala kërkuese mbi ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të sekuestruar të cilat në përgjithësi kanë qenë në formën e dhurimeve, huave dhe kredive për shtetasen E.S dhe shoqërinë “XXX XXXXXXXX” si dhe të personave që janë përfshirë në këto transaksione aktualisht janë pjesë e verifikimit që duhet të realizohet nga prokuroria. Njëkohëshit pjesë e verifikimit të burimeve të ligjshme të dhënies së dhurimeve, huave dhe kredive janë edhe personat që janë përfshirë në marrëdhëniet e detyrimeve ku si palë përfituese në cdo rast ka qenë shtetasja E.S dhe shoqëria “XXX XXXXXXXX”.

Në rastin konkret referuar nenit 12/b paragrafi i dytë i ligjit të posaçëm vetëm në një situatë të parashikuar nga kjo dispozitë gjykata mund të revokojë vendimin e saj të sekuestrimit të pasurisë. Rasti i revokimit të sekuestrimit mund të realizohet nga gjykata nëse pasuritë për të cilat vendoset revokimi i sekuestrimit, zëvendësohen me pasuri të barasvlefshme kur të gjitha palët japin pëlqimin dhe gjykata e çmon të përshtatshme. Pasuritë e barasvlefshme për zëvendësim duhet të ofrohen nga pala kundër së cilës është vendosur masa parandaluese e sekuestrimit të pasurive.

Në rastin konkret pala kërkuese nuk ofroi pasuri të barasvlefshme për t’ju nënshtruar më pas gjykimit dhe vlerësimit të gjykatës mbi mundësinë e revokimit të sekuestrimit dhe zëvendësimit të saj me sekuestrimin e pasurisë së barasvlefshme. Ndodhur në këto kushte kërkesa për revokim e paraqitur nga pala kërkuese nuk është e mbështetur në ligj dhe si e tillë ajo refuzohet nga gjykata.

### **PËR KËTO ARSYE**

*parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,*

## **VENDOSI**

- Refuzimin e kërkesës për revokimin e masës së sekuestros të vendosur nga gjykata e shkallës së parë “Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” me vendimin nr. 03 datë 07. 02. 2020 për pasuritë në zotrim të palës kërkuese.

- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.

- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit “Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes të këtij vendimi.

*U shpall në Tiranë më datë 03. 06. 2020.*

**SEKRETARE**

**GJYQTARI**

**NESILA XHEMALI**

**KLODIAN KURUSHI**

**SHPENZIMET GJYQËSORE**  
(Sipas neneve NNN të K. Pr. Civile)

Taksë rregjistrimi	Lekë
Taksë eksperti	Lekë
Për dëshmitar	Lekë

Për avokat	Lekë
Për njoftime	Lekë

TOTALI I SHPENZIMEVE: ( Lekë)	Lekë
----------------------------------	------

Sekretarja Gjyqësore

---

Nesila Xhemali

